

RREGULLORE PER SIGURINE NE PUNE, MBROJTJEN E SHENDETIT TE TE PUNESUARVE DHE TE AMBIENTEVE TE PUNES

❖ DISPOZITA TE PERGJITHESHME:

Objekti

Objekti i kësaj Rregulloreje është përcaktimi i masave, që synojnë garantimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë të punëmarrësve.

Baza ligjore

L I G J Nr. 10 237, datë 18.2.2010 PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË

- Kjo rregullore permban parimet e pergjitheshme per parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktoreve te rrezikut dhe aksidenteve ne pune, si dhe mbrojtjen e ambientit i punes, nepermjet informimit, konsultimit dhe trajnimit te punonjesve.
- Vendi i punes eshte cdo hapesire ku kryhet veprimtaria ne pune.
- Siguria ne pune, mbrojtja e shendetit te te punesuarve dhe ambientit te punes eshte pjese integrale e organizimit te punes dhe e procesit te punes. Ajo duhet te vije ne funksion, permes aktivitetit te punedhenesit permes marreveshjeve, rregullave te kontraktuara dhe udhezimeve te percaktuara prej tij.
- Te drejte per siguri ne pune, mbrojtje te shendetit te te punesuarve dhe ambientit te punes me kete rregullore kane:
 - Te gjithë punonjesit e Organizates;
 - Personat qe jane ne trajnim profesional tek punedhenesi te cilet nuk kane ende nje kontrate pune,
 - Pjesemarresit ne pune vullnetare apo pune te tjera te organizuara per interes te organizates.
- Masat e ndermarra per siguri ne pune, mbrojtje te shendetit te te punesuarve dhe ambientit te punes nga punedhenesi nuk e detyrojne punonjesin ne asnje obligim financiar.
- Punedhenesi duhet t’iu permbahet masave te nevojshme per siguri dhe shendet ne pune, te kujdeset per shendetin e tij dhe te personave te tjere te indikuar nga veprimet e tij. Gjate punes duhet te shfrytezohen ne menyren e duhur mjetet e sigurise ne pune, paisjet

mbrojtese individuale te cilat duhet te perdoren me kujdes dhe te ruhen ne gjendje funksionale.

- Me rastin e riorganizimit të punës, rikonstruktimit dhe blerjes së mjeteve të reja të punës, çdoherë duhen të zbatohen dhe sigurohen masa përkatëse të sigurisë në punë.

❖ **DETYRIMET DHE PERGJEGJESITE E PUNEDHENESIT:**

- Punedhenesi eshte i detyruar te krijojë kushte te mira per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune dhe merr të gjitha masat e nevojshme për të garantuar sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit mendor dhe fizik të punonjësve; Kodi punes
- Punedhenesi eshte i detyruar te organizoje dhe ndermarre masat e nevojshme per sigurine ne pune, shendetin e punonjesve dhe kushtet e punes perfshire parandalimin e rreziqeve ne pune ofrimin e informatave, trajnimeve, organizimit përkatës dhe masave të duhura për të siguruar dhe mirëmbajtur makineritë, instrumentet, pajisjet, veglat, vendin e punës.
- Punedhenesi duhet te kontrolloje efektshmerine e masave parandaluese dhe te marre masa per ti permiresuar ato ekzistuese edhe me tej.
- Mjetet për pajisje mbrojtëse personale (PPM), të percaktuara në Ligjin për siguri në punë, mbrojtje të shëndetit të punonjësve dhe ambientit të punës, të përshkruara në nenin 33 të kësaj Rregulloreje, do të sigurohen nga punëdhënësi.
- Punedhenesi do te beje vleresimin e rrezikut per sejcilin vend te punes. Vendet e ngjashme te punes grupohen ne nje.
- Punedhenesi detyrohet qe ne rast te lendimeve apo semundjeve te papritura ti siguroje punemarresit:
 - Dhenien e ndihmes se pare,
 - Evakuimin ne menyre adekuate,
 - Kontakte me sherbimet perkatese te sigurise,
 - Kujdesin mjeksor urgjent te emergjences,
 - Mbrojtjen kunder zjarrit,
 - Trainimin e nje numri te caktuar te te punesuarve per dhenien e ndihmes se shpejte, ne raport me numrin e pergjitheshem te te punesuarve,
 - Evakuimin dhe shpetimin e te punesuarve ne rast rreziku te mundeshem.
- Punedhenesi duhet te informoj punemarresit mbi aktivitetet qe ata/ato kryejne. Punemarresi duhet te informoje punetoret te cilet jane te ekspozuar kundrejt rrezikut si dhe te siguroje masat mbrojtese ne pune kundrejt ketyre rreziqeve. Duke pasur parasysh trajnimin që është bërë dhe mjetet teknike në dispozicion, punëmarrësit nuk do të pësojnë dëme për akte të tilla, përveç në rastet e neglizhencës flagrante ose sabotimit të qëllimshëm.
- Punedhenesi duhet te informoj menjehere organet kompetente per te gjitha rastet e aksidenteve ne pune me pasoja te ndryshme, qe nga ato fatale per jeten e deri tek ato me

te lehtat. Punedhenesi i pergjigjet punemarresit per demin e shkaktuar per rastin e lendimeve ne pune dhe semundjeve profesionale qe kane te bejne me punen sipas parimit te pergjegjesise objektive te se drejtes detyrimore.

- Semundjet profesionale percaktohen me ligjin perkates per shendetin dhe mbrojtjen shendetesore.

❖ **TE DREJTAT DHE PERGJEGJESITE E PUNEMARRESIT:**

- Punemarresi ka per detyre sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune dhe ambientet e saj.
- Punemarresi eshte i detyruar tu permbahet masave te nevojshme per sigurine ne pune dhe mbrojtjen e shendetit ne ambientet e punes.
- Eshte e drejte e punonjesve te zgjedhin ose emerojne perfaqesuesit e tyre per sigurine ne pune dhe mbrojtjen e shendetit.
- Punonjesi duhet ta njoftoje menjehere punemarresin per cdo mangesi, rrezik, problem shendetesor apo tjetër i/e cili/a mund te rrezikojë jeten e tij apo te punetoreve te tjere.
- Punonjesi ka te drejte ta refuzoje punen nese ka arsye te besojë se ekziston rrezik per jeten e tij apo te punonjesve te tjere.
- Punonjesi bashkepunon me punedhenesin per tu siguruar qe mjedisi i punes dhe kushtet jane te sigurta dhe se masat e dhena nga Inspektoriati i Punes zbatohen nga Punedhenesi.
- Eshte e drejte e punonjesit te konsultohet me punedhenesit mbi te gjitha aspektet e sigurise ne pune, mbrojtjes se shendetit dhe mjedisit te punes.
- Punonjesi ka te drejte te raportojë mungesen apo demtimin e PMI-ve (Paisje Mbrojtese Individuale).
- Punëmarrësi ka të drejtë të sygjerojë përmirësimin e situatës së mbrojtjes dhe shëndetit në vendin e punës.
- Punëmarrësi është i obliguar që, pa vonesë, ta lajmërojë drejtpërdrejtë punëdhënësin ose personin tjetër të autorizuar, për çdo lëndim që i ndodh në punë.

❖ **PARANDALIMI I ZJARREVE:**

- Sigurimi ne menyre te panderprere i masave parandaluese per eleminimin e shkaqeve te zjarrit.
- Anetaret e skuaders ne postet e punes te mos lejojne shkeljen e rregullave te ruajtjes e administrimit te vlerave material, dokumentare e monetare dhe te zbatojne rregullat e sigurimit teknik ne pune pergjate shfrytezimit te aparaturave e paisjeve te cilat mund te jene burim i perhapjes se zjarrit.

- Te kontrollohet gjendja teknike e instalimeve dhe aparaturave elektrike e elektronike dhe per cdo konstatim te bejne raporte teknike dhe pergjegjesite per marrjen e masave dhe eliminimin e tyre.
- Ne menyre periodike te behet pergatitje profesionale per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin me te gjithe anetaret e skuadres.
- Te kryhet nje stervitje paraprake ne praktike per menyren e perdorimit te paisjeve zjarrfikese dhe te kontrollohet vazhdimisht gatishmeria e ketyre paisjeve.

❖ **MASAT PER MBROJTJEN NGA ZJARRI:**

Mbrojtja e jetes se njeriut dhe e pasurise nga rreziku i zjarrit, eshte qellimi i percaktimit dhe zbatimit te kerkesave te rregullores.

- Shkaqe per zjarr behen:
 - 1- Padija e rregullave te mbrojtjes nga zjarri dhe sigurimi teknik;
 - 2- Shfrytezimi jashte kushteve teknike te paisjeve elektrike e elektronike;
 - 3- Qendrimi i pakujdesshem i personelit
- Ne zyren kryesore dhe deget e saj, vendosen kende te emergjences dhe te njoftimeve ku te publikohen:
 - 1- Masat per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin,
 - 2- Organizimi dhe perberja e skuadres per mbrojtjen nga zjarri,
 - 3- Detyrat e skuadres per parandalimin e zjarrit,
 - 4- Veprimet konkrete te skuadres dhe cdo anetari ne rast zjarri.
- Fikeset e zjarrit vendosen ne vende te dukeshme dhe lehtesisht te perdoreshme,
- Punonjesit te jene te instruktuar per masat mbrojtese nga zjarri dhe perdorimin e fikseve,
- Ndalohet ne mjediset e punes:
 - 1- Pirja e duhanit,
 - 2- Ngrohja me soba, furnela elektrike apo paisje te tjera te pamiratuara,
 - 3- Instalime provizore,
 - 4- Perdorimi i cdo flake te lire dhe cdo mjeti qe shkakton zjarr.
- Ndalohet rreptesisht ndryshimi i skemes se rrjetit elektrik dhe elektronik i pamiratuar,
- Materialet sistemohen qe te kene rruge te lira kalimi dhe evakuimi,
- Pas perfundimit te punes, pastrohen skarcitetet dhe mbetjet duke i shpure ne vendin e grumbullimit te paracaktuar e miratuar me pare,
- Cdo klient apo person tjetër është i detyruar te zbatoje rregulloren e brendeshme,
- Punonjesit pergjigjen per gatishmerine e fikseve te zjarrit,
- Ne rast zjarri, skuadra MNZSH dhe punonjesit kane per detyre:
 - 1- Te evakuoje personelin e rrezikuar
 - 2- Te evakuoje vlerat monetare, materiale e dokumentare
 - 3- Te lajmeroje stacionin zjarrfikes
 - 4- Te perdore mjetet e fikjes se zjarrit qe kane ne perdorim per kete qellim

- Vendosja e posterave sensibilizues ne vende te dukshme per rrezikun ndaj zjarrit si dhe numrat e emergjences per zjarrfikesit, policine dhe spitalin.

❖ **SIGURIA DHE SHËNDETI PËR PUNËN ME PAJISJE ME EKRAN SHFAQËS:**

- Kjo rregullore përcakton kërkesat minimale për sigurinë dhe shëndetin për punën me pajisje me ekran shfaqës.

- **Përkufizime**

Për qëllim të kësaj rregulloreje, termat e përdorur kanë kuptimet e mëposhtme:

a) “Pajisje me ekran shfaqës” është çdo ekran shfaqës, që reflekton shkronja, numra, shenja ose figura, pavarësisht procesit të shfaqjes që përdoret;

b) “Vendi individual i punës” është një tërësi elementesh, që përfshin pajisjet me ekran shfaqës, që mund të shoqërohen me tastierë, ose pajisje për hedhjen e informacionit dhe/ose software-in, i cili përcakton ndërfaqen operator-makinë, pajisjet ndihmëse fakultative, pajisjet e jashtme duke përfshirë telefonin, modemin, printerin, mbajtësen e dokumenteve, karrigen dhe tryezën e punës ose sipërfaqen e punës, si dhe mjedisin e punës përreth tij.

c) “Punëmarrës në punë me pajisje me ekran shfaqës” është çdo punëmarrës, siç përkufizohet në ligjin nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i cili përdor rregullisht pajisje me ekran shfaqës, jo më pak se 4 orë në ditë pune.

ç) “Ergonomia” është një disiplinë, e cila fokusohet te parimet e projektimit të elementeve të sistemit të punës, përfshirë objektet, proceset dhe kushtet e punës, që t’i përshtaten njeriut, me qëllim zvogëlimin e sforcimit fizik, parahatisë dhe risqeve.

- **Analiza e vendeve individuale të punës**

1. Punëdhënësi kryen një analizë të vendeve individuale të punës, për të vlerësuar kushtet e sigurisë dhe shëndetit për punëmarrësit, veçanërisht lidhur me risqet e mundshme për shikimin, lodhjen fizike dhe mendore.
2. Punëdhënësi merr masa të përshtatshme për të korrigjuar kushtet e punës dhe për të zvogëluar ose eliminuar risqet e gjetura, mbi bazën e vlerësimit të përmendur në pikën 1, duke marrë parasysh efektet shtesë dhe/ose të kombinuara të risqeve të konstatuara.
3. Punëdhënësi ndërmerr hapa të përshtatshme për të siguruar që vendi individual i punës të plotësojë kërkesat e kësaj rregulloreje.

- **Puna e përditshme**

1. Punëdhënësi planifikon veprimtaritë e punëmarrësit në mënyrë të tillë që, puna me ekran shfaqës, të ndërpritet rregullisht, nëpërmjet pushimeve ose ndryshimeve të veprimtarisë, për të zvogëluar ngarkesën e punës me ekran shfaqës.
- **Konsultimi dhe pjesëmarrja e punëmarrësve**
 1. Në përputhje me nenin 13 të ligjit nr. 10237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, punëdhënësi merr masa të përshtatshme për konsultimin dhe pjesëmarrjen e punëmarrësve në lidhje me punën me pajisje me ekran shfaqës, rezultatet e analizës së vendeve të punës dhe masat që duhet të merren, për të zvogëluar dhe eliminuar aspektet negative të punës.
 - **Mbikëqyrja shëndetësore**
 - **Kërkesa Minimale**
 1. Përdorimi i pajisjes me ekran shfaqës, në vendin individual të punës, nuk paraqet risk për sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve,
 2. Imazhi në ekran është i qëndrueshëm, pa dridhje ose forma të tjera të paqëndrueshmërisë,
 3. Distanca optimale e të parit, ndërmjet syrit të punëmarrësit dhe detajit të vëzhguar në ekran, varet nga përmasa e detajit dhe ekranit shfaqës dhe është ndërmjet 500-700 mm. Distanca e të parit nuk duhet të jetë më e vogël se 400 mm,
 4. Tastiera:
 - Është e anueshme dhe e ndarë nga ekрани në mënyrë që punëmarrësi të gjejë pozicion të rehatshëm pune duke shmangur lodhjen e duarve ose krahëve.
 - Hapësira përballë tastierës është e mjaftueshme për të ofruar mbështetje për duart dhe krahët e punëmarrësit.
 - Tastiera ka sipërfaqe jo reflektuese për të shmangur shkëlqimin verbues.
 - Dizenjimi dhe përmasat e butonave të tastierës lehtësojnë përdorimin e saj.
 - Në butonat e tastierës janë me kontrast të mjaftueshëm dhe të lexueshme nga pozicioni normal i punës,
 - 1. Tryeza e punës ose platforma e punës:
 - Tryeza ose syprina e punës kanë sipërfaqe të mjaftueshme, me gjatësi të paktën 1200 mm dhe me gjerësi të paktën 750 mm, me reflektim të ulët dhe lejojnë vendosje të përshtatshme të ekranit, tastierës, dokumenteve dhe pajisjeve të lidhura.
 - Mbajtësja e dokumenteve është e qëndrueshme dhe e përshtatshme dhe pozicionohet në mënyrë që të minimizojë nevojën për lëvizje të parehatshme të kokës dhe të syve.
 - Hapësira e punës është e mjaftueshme për punëmarrësin për të gjetur një pozicion pune të rehatshëm dhe për të ndryshuar pozicionin e këmbëve. Hapësira poshtë pjesës

ku punohet ka lartësi prej të paktën 650 mm, gjerësi 500-800 mm dhe thellësi prej 750 mm

2. Karrigia e punës:

- Karrigia e punës është e qëndrueshme dhe i lejon punëmarrësit lirshmëri lëvizjeje dhe pozicion të rehatshëm.
- Ndenjësja ka lartësi të ndryshueshme prej 400 deri 520 mm, thellësi prej 350 deri 500 mm dhe gjerësi rreth 480 mm.
- Mbështetësja e ndenjësës është e ndryshueshme në lartësi dhe në pjerrësi
- Është e përshtatshme që ndenjësja të jetë e pajisur me mbështetëse për çlodhjen e krahëve, me lartësi rreth 270 mm mbi ndenjësën, gjerësi minimale prej 70 mm dhe distanca ndërmjet vendeve për çlodhjen e krahëve prej 500 mm.
- Mbështetëse për këmbët ofrohet për çdo punëmarrës sipas kërkesës së tij. Mbështetësja për këmbët ka lartësi dhe pjerrësi të ndryshueshme nga 50 deri 150, gjatësi minimale prej 450 mm, gjerësi minimale prej 300 mm dhe sipërfaqe jo rrëshqitëse;

3. Kërkesa të hapësirës :

- Hapësira e vendit individual të punës është jo më pak se 12m³ për person dhe projektohet në mënyrë të tillë që të ofrojë lehtësi për ndryshimin e pozicionit dhe kryerjen e lëvizjeve të punëmarrësit,
- Ndriçimi i mjedisit të punës dhe/ose ndriçimi i vendit individual të punës sigurohet në nivele nga 300 deri 700 luks dhe me kontrast të përshtatshëm ndërmjet ekranit dhe mjedisit në sfond, duke marrë parasysh llojin e punës dhe nevojat e shikimit të përdoruesit.
- Shkëlqimi i mundshëm verbues shqetësues dhe reflektimet në ekran ose pajisje të tjera parandalohen nëpërmjet përshtatjes së vendit të punës dhe vendit individual të punës me pozicionimin dhe karakteristikat teknike të burimeve artificiale të dritës,
- Gjatë mobilimit të vendit ose vendeve individuale të punës, merret parasysh që zhurma e emetuar nga pajisjet të mos kalojë vlerën prej 60dB(A) në vendin individual, për të mos shpërqendruar vëmendjen ose vështirësuar komunikimin,
- Pajisjet që i përkasin vendit ose vendeve individuale të punës nuk prodhojnë nxehtësi të tepërt, që mund të shkaktojë parehati për punëmarrësit. Temperatura optimale është 22-27o C dhe temperatura e pranueshme 18-30o C,
- Niveli i lagështisë mbahet në nivele të pranueshme, ndërmjet 30-70%.
- Pajisjet e siguruara nga punëdhënësi, përfshirë instrumentet manuale, me apo pa motor:
 - instalohen dhe përdoren në mënyrë korrekte;
 - mirëmbahen në kushte të mira funksionale;
 - u kryen shërbimet nga punëmarrës apo persona të trajnuar në mënyrë të përshtatshme;

- përdoren vetëm në përputhje me qëllimin e tyre;
- Kur pajisja e punës krijon risqe të veçanta për sigurinë ose shëndetin e punëmarrësve, punëdhënësi merr masat e nevojshme për të siguruar që:
 - a) përdorimi i pajisjes së punës të lejohet vetëm për ata persona, që u është dhënë detyra për t'i përdorur ato;
 - b) në rastin e instalimeve, ç'instalimeve, ndryshimeve, përshtatjeve, mirëmbajtjes, shërbimeve dhe riparimeve të pajisjes së përdorur, punëmarrësit që i kryejnë ato, janë ata që janë të kualifikuar dhe janë ngarkuar veçanërisht për këtë punë. Operacionet e mirëmbajtjes kryhen vetëm atëherë kur pajisja është e fikur. Në rast të kundërt, merren masat e duhura për kryerjen e këtyre operacioneve jashtë zonave të rrezikut. Në rastet kur makineria ka libër mirëmbajtjeje, ky i fundit përditësohet rregullisht. Pajisjet e punës kanë shenja paralajmëruese, të dallueshme për të garantuar sigurinë e punonjësve.
- Punëmarrësit dhe persona të tjerë pranë pajisjeve të punës duhet të kenë akses të sigurt dhe mundësi qëndrimi të sigurt në të gjitha zonat e nevojshme gjatë proceseve të riparimit dhe të mirëmbajtjes.
- Të gjitha pajisjet e punës janë të përshtatshme për mbrojtjen e punonjësve nga risku i marrjes flakë apo mbinxehjes së tyre, shkarkimit të gazrave, pluhurit, lëngut, avullit ose substancave të tjera të prodhuara, të përdorura ose të depozituara në pajisjet e punës.
- Të gjitha pajisjet e punës duhet të jenë të përshtatshme për parandalimin e riskut të shpërthimit të pajisjeve të punës apo të substancave të prodhuara, të përdorura apo të depozituara në pajisjet e punës.
- Të gjitha pajisjet e punës duhet të jenë të përshtatshme për mbrojtjen e punonjësve apo personave të tjerë, që janë të ekspozuar ndaj riskut të kontaktit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me energjinë elektrike.

Mjetet e lëvizshme të punës me persona në bord, pajisen në mënyrë të tillë që zvogëlon risqet për personat gjatë udhëtimit.

❖ **GRUPET E RREZIKUARA:**

- Gratë shtatzëna, gratë me fëmijë në gji, si dhe personat me aftësi të kufizuar mbrohen ndaj rreziqeve, që i prekin ata në mënyrë të veçantë. Të drejtat dhe obligimet e këtyre personave, rregullohen me Kodin e Punes.
- Organizata përshtat vendet e punës, duke marrë parasysh praninë e grupeve, që janë të ndjeshme ndaj rreziqeve.

- Mbrojtja e sigurisë dhe e shëndetit për grupet, që janë të ndjeshme ndaj rreziqeve, nuk duhet të përbëjë shkak për të krijuar situata të pafavorshme për gruan në tregun e punës.

❖ RREGULLAT E SIGURISË ELEKTRIKE

Rregullat e sigurisë:

Aksidentet elektrike zakonisht mund të ndodhin për shkak të defekteve teknike, p.sh. mungesa e atribuuar e pjesëve mbrojtëse apo izolimi i gabuar. Mangësitë organizative, për shembull mungesa ose procedurat operative të papërshtatshme dhe gabimet personale çojnë në aksidente. Pajisjet duhet pra të jenë të sigurta dhe në gjendje perfekte teknike. Shumica e aksidenteve mund të shmangen duke shfaqur kujdes dhe masa parandaluese. Defekte në mjete, makineri dhe pajisje duhet të raportohet menjëherë, sepse përndryshe dikush tjetër mund të pësojë aksident para bërjes së këtij njoftimi.

- Punoni në mënyrë të sigurtë dhe me mençuri
- Zbatoni dhe respektoni rregulloren e sigurise teknike ne pune
- Merrni informacion paraprak per punet/detyrat e reja me te cilat nuk jeni perballur me pare
- Shfrytëzoni sigurinë pasive
- Vishni pajisje mbrojtëse personale
- Respektoni ndalimet, për shembull ndalimin e alkoolt, ndalimin e pirjes së duhanit, ndalim hyrje.
- Raportoni ose eliminoni menjëherë mangësitë e sigurisë ose kushtet e rrezikshme.
- Mos përdorni pa leje makineri, vegla apo pajisje pune.
- Mbani zonën e punës të rregullt.

Para se të filloni punë në sistemet elektrike:

- Shkëpusni korentin
- Sigurohuni që të mos lidhet korenti pa e mbaruar punen
- Përcaktoni tensionin e lejuar
- Tokëzimi dhe qarku i shkurtër
- Mbuloni dhe ndani zonën e punës me anë të një kordoni
- Zbatoni dhe respektoni rregulloren e sigurise teknike ne pune.
- Njohuri fillestare teknike për impiantet, instalimet dhe pajisjet elektrike;
- Njohuri të plota mbi rrezikun që paraqet rryma elektrike dhe afrimi pranë përcjellësve me tension dhe gjatë punimeve në impiantet ose linjat elektrike.
- Njohuri mbi masat kryesore të mbrojtjes gjatë punimeve në impiante, instalime dhe pajisje elektrike.
- Njohuri mbi rregullat e përgjithshme të sigurimit teknik.

- Njohuri të rregullave të veçanta të sigurimit teknik për ato lloj punimesh që futen në kuadrin e detyrave të tyre
- Njohuri praktike mbi dhënien e ndihmës së parë.

Detyrimet e punëdhënësit

1. Punëdhënësi merr masat e duhura që pajisjet dhe instalimet elektrike, të vëna në dispozicion të punëmarrësve të ndërmarrjes ose të institucionit, të jenë të përshtatshme për punën që do të kryhet, duke garantuar sigurinë dhe shëndetin.
2. Punëdhënësi merr masat e duhura që pajisjet dhe instalimet elektrike gjatë përdorimit të tyre të mirëmbahen nëpërmjet kryerjes së shërbimeve, të riparimeve dhe të pastrimeve në një nivel të tillë që të plotësojnë kërkesat e rregulloreve teknike.
3. Çdo instalim elektrik duhet të ketë projektin përkatës. Çdo montim ose rikonstruksion në instalimet elektrike bëhet me projekt.

Informimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi merr masat e nevojshme që punëmarrësi të marrë të dhënat e duhura dhe udhëzimet përkatëse për përdorimin e pajisjeve elektrike.
2. Të dhënat dhe instruksionet për përdorimin e pajisjeve elektrike duhet të përmbajnë të paktën treguesit për sigurinë dhe shëndetin, përsa u përket:
 - a) kushteve të shfrytëzimit të pajisjeve elektrike;
 - b) situatave anormale të parashikueshme;
 - c) përdorimit të mjeteve mbrojtëse individuale dhe kolektive për parandalimin e aksidenteve në punë;
 - ç) dhënies së ndihmës së parë mjekësore në rast aksidenti.
3. Të dhënat dhe udhëzimet për përdorimin e pajisjeve elektrike duhet të jenë të kuptueshme për përdoruesin.

Formimi i punëmarrësve

1. Punëdhënësi merr masat e nevojshme që:
 - a) Përdorimi i pajisjeve elektrike të bëhet nga punëmarrës që kanë përgatitje të mjaftueshme, të dokumentuar me dëshmi aftësie perkatese;
 - b) Në rastin e riparimit, të modifikimit ose mirëmbajtjes së pajisjeve ose të instalimeve elektrike, punëmarrësit e interesuar duhet të kualifikohen në mënyrë të posaçme për t'i kryer këto detyra.
2. Punëdhënësi siguron që punëmarrësit të njihen me të dhënat e duhura dhe t'u bëhet instruktimi:
 - a) kur caktohen në vendin e punës;
 - b) kur në pajisjen elektrike që përdoret bëhen modifikime;
 - c) periodikisht, të paktën një herë në vit. shëndetin, në përputhje me nenin 8 pika 2.
3. Punëmarrësit duhet të bëhen të vetëdijshëm për rreziqet që paraqesin për ta pajisjet

elektrike që përdorin dhe për çdo ndryshim që ndikon në sigurinë e tyre.

❖ **DETYRIMI PER BASHKEPUNIM**

Organizata është e ndërgjegjshme për detyrimin që ajo ka për të bashkëpunuar me Inspektoriatin Shtetëror të Punës dhe për t'i siguruar të gjithë informacionin që ai kërkon për zbatimin të legjislacionit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë.